

16 prill 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Komuna e Prizrenit telashe me transparencën e ekzekutivit

Duke u bazuar në Ligjin për qasje në dokumente publike dhe Rregulloren komunale për transparencë, organizata jo-qeveritare EC Ma Ndryshe, ka parashtruar një kërkesë në drejtim të Kryetarit të Komunës së Prizrenit z. Ramadan Muja, Drejtorisë së Arsimit dhe asaj të Shëndetësisë. Kërkesa si e tillë është parashtruar me datë 02.04.2012 me numër protokoll 01/031-3411; ku edhe është kërkuar nga kabineti i Kryetarit të Komunës që të na mundësojnë qasje në Planin Vjetor të punës së Kryetarit për vitin. Po ashtu, nga drejtoritë përkatëse është kërkuar informata në lidhje me numrin e vendimeve të marra nga 1 janari 2012 deri më 30 mars 2012. Duke u bazuar mbi Ligjin për qasje në dokumentet publike nr.03/L-215; institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj. EC Ma Ndryshe ka marrë përgjigje vetëm nga ana e Drejtorisë së Arsimit ku janë specifikuar vendimet e marra nga data 1 janar 2012, ndërsa kërkesës nuk i janë përgjigjur Kryetari i komunës së Prizrenit dhe Drejtorja e Shëndetësisë.

Projekti për monitorimin e transparencës së ekzekutivit

Këto veprime EC Ma Ndryshe po i ndërmerr në kuadër të projektit për monitorimin e transparencës së qeverisjes lokale në Prizren, i cili ka filluar në muajin prill 2012. Fokusi themelor i monitorimit do të jetë ekzekutivi i komunës (kryetari i komunës dhe drejtoritë) si dhe shërbimi civil. Monitorimi do të përfomohet përmes monitoruesve permanentë, të cilët do të kenë prezencë të rregullt në zyrat komunale dhe qasje në dokumentet zyrtare të komunës. Raportimi i të gjeturave të monitorimit do të përdorë gjithashtu një mekenizëm permanent, web-faqen e transparencës së qeverisjes lokale. Të gjeturat e monitorimit do të postohen drejtpërdrejtë në web-faqen e projektit, për të krijuar mundësi qasjeje për të gjitha palët e interesuara. Të gjeturat e monitorimit do të jenë bazë e veprimit për nivelin e dytë të aktiviteteve të projektit, avokimin dhe adresimin e shkeljeve ligjore. Organizata do të përdorë mundësitë ligjore për të nisur procedura të adresimit të shkeljeve ligjore nga ana e komunës. Web-faqja e projektit është në fazën e përpunimit nga një kompani e specializuar për zhvillimin e web-faqeve dhe do të publikohet në muajin maj 2012. Projekti mbështetet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).

Kryetari i komunës nuk i përgjigjet kërkesës për qasje në dokumente publike

Kërkesa e parë për qasje në dokumente publike dhe informata të punës së ekzekutivit të komunës së Prizrenit ka rezultuar me shkelje të Ligjit për qasjen në dokumente publike nga Kryetari i komunës dhe Drejtorja për Shëndetësi. Nga mospërgjigjia mund të konstatohet se Kryetari i komunës së Prizrenit nuk ka Plan Vjetor të Punës dhe ekzekutivin e komunës e udhëheq pa planifikim. Nëse ky konstatim nuk qëndron, ne i bëjmë thirrja Kryetarit të komunës që të na ofrojë qasje në Planin e tij të Punës. Gjithashtu, rekomandojmë që Kryetari dhe drejtoritë komunale të jenë proaktive në publikimin e vendimeve që i marrin, duke e shfrytëzuar web-faqen e komunës.

Web-faqja e komunës së Prizrenit, mekanizëm joefektiv

Web-faqja e komunës së Prizrenit është një mundësi e mirë për rritjen e transparencës komunale. Megjithatë, komuna e Prizrenit është treguar mjaft pasive në vendosjen e informatave relevante rreth vendimmarrjes në web-faqe. Në të shumtën e rasteve, në web-faqe postohen

vendimet e marra në formën e tyre përfundimtare. Kjo praktikë është në kundërshtim me kërksat e qeverisjes demokratike, e cila kërkon krijimin e mundësive për pjesëmarrje dhe ndikim qytetar në marrjen e vendimeve.

Rregullorja komunale për Transparencë, joobligative për ekzekutivin

Kohëve të fundit, Kuvendi Komunal i Prizrenit ka miratuar Rregulloren për Transparencë, së cilës i mungon komponenta e transparencës së ekzekutivit. Ndonëse ky defekt rrjedh nga udhëzimi administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, rekomandojmë që komuna e Prizrenit të përfshijë edhe komponentën e transparencës së ekzekutivit, duke i precizuar veprimet që Kryetari i komunës dhe drejtoritë komunale duhet të ndërmarrin në emër të vendimmarrjes transparente. Ekzekutivi i komunës, i cili tashmë udhëhiqet nga kryetari i komunës (i cili i emëron dhe shkarkon drejtorët komunalë sipas vullnetit të tij personal), po promovon një cilësi të re të qeverisjes lokale dhe të ofrimit të shërbimeve publike. Ndonëse ky ndryshim cilësie nuk është gjithmonë cilësor, ekzekutivi i komunës (sidomos kryetari) po shndërrohet në adresën e vetme të përgjegjësive, dhe si pasojë të llogaridhënies, në raport me qeverisjen e mirë dhe shërbimet cilësore publike. Mbikëqyrja e punës së kryetarit (sidomos pjesa e ligjshmërisë) është ndër sfidat më të mëdha të qeverisjes lokale në Kosovë. Derisa Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal vlerësohet jo mjaftueshëm efektive, as Kuvendet Komunale dhe sistemi gjyqësor nuk dëshmojnë për cilësi më të larta. Dimensionimi i fundit i kësaj mbikëqyrjeje, kontrolli qytetar, krahas pengesave politike, po has edhe në absurditete ligjore (Neni 72 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale për largimin e kryetarit nga detyra).

Kryetarët e komunave, probleme me ligjin

Janë evidentuar shumë raste gjatë këtyre dy mandateve të fundit, kur Kryetarë komunash kanë vepruar pa konsultim paraprak me Kuvendin Komunal dhe në shumë raste pa vendim të këtij organi. Kjo praktikë ka ngritur shqetësime të shumta në raport me respektimin e ligjit nëpër komunat e Kosovës. Përkrahësit e sistemit mayoral janë të vetëdijshëm për formulën e dëmtimit të demokracisë në nivel lokal. Kjo formulë arrihet kur Kryetari i komunës tregohet shumë i sofistikuar në aftësitë e tij manipuluese, derisa në të njëjtën kohë Kuvendi Komunal tregohet i ngathtë në përmbushjen e obligimeve dhe ushtrimin e plotë të kompetencave (ligjore dhe mbikëqyrëse). Disa nga rastet e keqpërdorimit të pushtetit ekzekutiv janë shfaqur në komunën e Prizrenit, derisa për njërin nga këta raste EULEX aktualisht është duke zhvilluar hetime ndaj kryetarit të komunës së Prizrenit. Për këtë arsye, monitorimi dhe raportimi për aktivitetet e keqqeverisjes (sidomos të ekzekutivit të komunës) do të duhej të ishte detyrë primare e shoqërisë civile në raport me qeverisjen e mirë në nivel lokal.

Projekti i EC Ma Ndryshes për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe prej muajit maj përmes web-faqes së projektit, ku të gjeturat do të postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit.

Ju falemnderit për bashkëpunimin tuaj,

Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 522 199 & +386 49 116 448

Projekti "Transparenca on-line e komunës së Prizrenit" mbështetet financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

SOROS

Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo